



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:158847

Datë: 05.08.2023

Numri i dokumentit: 04559046

**P.nr.25A/2023**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale të pandehurit A.S. nga Fshati B. KK Vushtrrisë, i akuzuar për veprat penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2, si dhe për veprën penale Mbajtja në Pronësi, Kontroll, Posedim të pa autorizuar të Armeve nga neni 366 paragrafi 1 i KPRK-së duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.4601/2023 të datës 28.07.2023, pas mbajtjes së seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me datë 03.08.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Besnik Jakupi, të pandehurit A.S. me mbrojtësin sipas autorizimit av. Kastriot Feka, si dhe të dëmtuarit A.Xh., me datë 03.08.2023 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 05.08.2023 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

A.S., i biri i S. dhe S., e gjinisë S., i lindur më ..., në fshatin B., komuna e V., me vendbanim Gj., me numër personal:..., i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, din shkrim lexim, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse:**

Me datën 20.07.2023 rreth orës 21:40 i pandehuri seriozisht e ka kanosur tani të dëmtuarin A.Xh. në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje që kishin në komunikacion, i pandehuri fillimisht me dorë e kishte goditur veturën e të dëmtuarit pastaj, i njëjti e kishte nxjerr armen nga brezi dhe ia kishte drejtuar të dëmtuarit, me çka tek i dëmtuari kishte shkaktuar ndjenjën e frike dhe të pa sigurisë për jetë

- *me këtë ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 i KPRK-së.*

Prej datës së pa vërtetuar e deri me datën 20.07.2023 rreth orës 21:40 i pandehuri në kundërshtim me ligjin për armët, ka mbajtur pa autorizim armet të llojit ... mm me numër serik ..., B.-G. me numër serik ... dhe G.ashtu që Policia e Kosovës me rastin e kontrollit tek i pandehuri i kanë gjetur dhe sekuestruar armët.

- me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në Pronësi, Kontroll, Posedim të pa autorizuar të Armeve nga neni 366 paragrafi 1 i KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 46,47,48, 69, 70, 71, 72 dhe 79 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

### **DËNIM ME KUSHT DHE DENIM ME GJOBË**

- I.** Për veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 i KPRK-së të akuzuarit A.S. Gjykata i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse në periudhën verifikuese prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.
- II.** Ndërsa për veprën penale Mbajtja në Pronësi, Kontroll, Posedim të pa autorizuar të Armeve nga neni 366 paragrafi 1 i KPRK-së të akuzuarit A.S. Gjykata i shqipton dënim me gjobë në shumen prej një mijë e pesëqind Euro (1,500.00€) të cilën gjobë i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi
- III.** Nëse i akuzuari nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje t' a paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do të i zëvendësohet me dënim me burg ashtu që për çdo 20 € (njëzet euro) do të i caktohet një ditë burgim.
- IV.** Në rast të revokimit të dënimit me kusht bazë të nenit 79 të KPRK-së të akuzuarit A.S. koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak do të i llogaritet në dënimin e shqiptuar me kusht.
- V.** Konfiskohen armët e tipit: a.) ..mm me numër serik ..., b.) B. –G.(me numër serik ... dhe c.) G.dhe URDHËROHET shkatërrimi i tyre nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me organet e tjera relevante, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimit.
- VI.** I dëmtuari A.Xh., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.
- VII.** Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën me numër PP/II.Nr.4601/2023 të datës 28.07.2023, kundër të akuzuarit A.S., për shkak të veprave penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 dhe Mbajtja në Pronësi, Kontroll, Posedim të pa autorizuar të Armeve nga neni 366 paragrafi 1 i KPRK-së.

Së bashku me aktakuzë është dorëzuar edhe marrëveshja për pranimin e fajësisë me numër PP.I.nr.4601/2023 e datës 28.07.2023, e lidhur në mes të Prokurorisë Themelore në Prishtinë në njërën anë dhe të akuzuarit A.S. me mbrojtësin e tij av. Kastriot Feka në anën tjetër.

Sipas kësaj marrëveshje Gjykatës i është rekomanduar që ndaj të akuzuarit për shkak të veprat penale për të cilat i pandehuri akuzohet, t'i shqiptohet dënimi i kushtëzuar me burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale dhe dënim me gjobë në shumën prej 1.500 Euro. Si dhe Gjykatës i është propozuar Konfiskimi i armëve: a.) ...mm me numër serik ..., b.) B. –G.(me numër serik ... dhe c.) G....

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me datë 03.08.2023, në të cilën seancë është shqyrtuar marrëveshja për pranimin e fajësisë ku është dëgjuar Prokurori i shtetit Besnik Jakupi, i akuzuari A.S., me mbrojtësin e tij av. Kastriot Feka, si dhe i dëmtuari A.Xh.

Prokurori i shtetit Besnik Jakupi, gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, ka deklaruar se pas autorizimit të marrë nga kryeprokurori i shtetit ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë ashtu siç edhe është precizuar në marrëveshje. Ka shtuar se mbetet pranë të njëjtës marrëveshje, ndërsa Gjykatës i ka propozuar që marrëveshjen si të tillë ta pranojë dhe e njëjta të jetë pjesë e shkresave të lëndës. Më tej shton se e plotësojmë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ashtu që i shtohet: masa e arrestit shtëpiak nga data 27.07.2023 t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. Kastriot Feka gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se mbesim pranë marrëveshjes se paraqitur pranë gjykatës dhe kërkojmë që Gjykata ta miratojë si të bazuar të njëjtën. Po ashtu ka kërkuar nga Gjykata ndërprerjen e masës së arrestit shtëpiak për të pandehurin pasi që kanë pushuar të gjitha arsyet për cilat kjo masë i është caktuar. E po ashtu Gjykatës i ka kërkuar kthimin e dokumenteve të personale të të pandehurit të cilat janë konfiskuar pasi që i ka të domosdoshme për udhëtim.

I akuzuari A.S. deklaron e mbështet fjalën e mbrojtësit të tij në lidhje me marrëveshjen e negociuar mbi pranimin e fajësisë.

I dëmtuari A.Xh. nëpërmjet përkthyeses se Gjykatës ka deklaruar se ndjehet i frikësuar nga i pandehuri pasi disa persona e kanë përcjellur atë me veturën e të akuzuarit para disa dite dhe ka kërkuar nga Gjykata që të i vazhdohet masa e arrestit shtëpiak, ndërsa lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se nuk kam asgjë kundër.

Lidhur me deklaratimet e të dëmtuarit mbrojtësi i të pandehurit ka replikuar duke deklaruar me tej se i njëjti ka lidhje familjare me të pandehurin dhe për këto dy jave kam qenë në shtëpinë e tij, 7-8 here dhe vetura asnjëherë nuk ka lëvizur e po ashtu e i mbrojturi im jeton në Gjermani, dhe nuk ka pasur kush ta vozis, e po ashtu deklaroj se po të njëjtën natë kur është arrestuar i mbrojturi im është arrestuar edhe i dyshuari për veprat penale aksidente të inskenuara, dhe konsiderojmë që gjykata nuk mund të ia falë besimin, dhe po ashtu e themi me bindje se vetura e të mbrojturit tim nuk ka lëvizur dhe s'ka pasur kush ta vozis.

Në seancën publike për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të mbajtur me datën 03.08.2023, pas shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, nën shenjë PP.I.nr.4601/2023 e datës 28.07.2023, e cila ka të bëjë me

të akuzuarin A.S., për shkak të veprave penale *Kanosja nga neni 181 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 dhe Mbajtja në Pronësi, Kontroll, Posedim të pa autorizuar të Armeve nga neni 366 paragrafi 1 i KPRK-së*. si dhe deklarimit për pranimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari në pajtim me dispozitat e nenit 230 par. 17 të KPRK-së, Gjykata ka gjetur se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, e njëjta është bërë në mënyrë të vullnetshme pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av. Kastriot Feka, i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë marrëveshjen e arritur për pranimin e fajësisë, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Gjithashtu, Gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet me aktakuzë dhe atë duke u bazuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, si dhe në provat tjera të cilat i përmban aktakuza të cilat prova janë të mjaftueshme për të vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, ku Gjykata po ashtu ka konstatuar se në shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë me nenin 248 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të KPRK-së për pushimin e procedurës përkatësisht hedhjen e aktakuzës, prandaj Gjykata pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ka mbështetje ligjore bazuar në nenin 230 paragrafi 20 të KPRK-së, andaj të njëjtën e ka pranuar dhe e ka vendosur në shkresat e lëndës.

Duke u bazuar në të lart cekurat gjyqtarja gjykuese ka vërtetuar gjendjen faktike ashtu që ka ardhur në përfundim se i akuzuari A.S., me dashje ka kryer veprat penale *Kanosja nga neni 181 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 dhe Mbajtja në Pronësi, Kontroll, Posedim të pa autorizuar të Armeve nga neni 366 paragrafi 1 i KPRK-së* në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjyqtarja gjykuese, të akuzuarin A.S. e ka shpallur fajtor për veprat penale për të cilën është ngarkuar ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprave penale *Kanosja nga neni 181 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 dhe Mbajtja në Pronësi, Kontroll, Posedim të pa autorizuar të Armeve nga neni 366 paragrafi 1 i KPRK-së* dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar se duhet të aprovohet rekomandimi i paraqitur në marrëveshjen për pranimin e fajësisë që ndaj të akuzuarit A.S. të shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën janë vlerësuar rrethana lehtësuese dhe se dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit Gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së. Kështu, si rrethanë lehtësuese gjykata ke vlerësuar faktin se i akuzuari ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Themelore në Prishtinë, i akuzuari ka bashkëpunuar me prokurorin e shtetit, sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, pendimi për kryerjen e veprës penale, premtimi që më nuk do të kryer veprime të tilla inkriminuese.

Andaj, duke pasur parasysh se i akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, si dhe duke mos gjetur rrethana rënduese, Gjykata ka ardhur në përfundim se këto janë rrethana, që tregojnë se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së. Te i akuzuari me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryej ndonjë veprë tjetër penale dhe se dënimi i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Po ashtu ky dënim do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të nenit 36 par.3 nën par.3.1 Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontestin juridiko- civil, gjykata e mori në bazë të nenit 462 par.2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA FUSHË KOSOVË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL**  
P.nr.25A/2023, datë: 05.08.2023

**Gjyqtarja Gjykuese**

**Laura Hoti Statovci**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30(tridhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.